



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR PROVUES

Viti shkollor 2016/2017

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.

1. Tekstet e poshtëshënuara janë të ndryshëm në mes veti, njëri është administrativ ndërsa tjetri publicistik. Dallo llojin e tekstit.

a) Liria dhe të drejtat e njeriut janë të garantuara sipas ligjeve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara. Ky organ e përcjell në vazhdimësi cenimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në botë, andaj çdo herë po kritikon vendin nga i cili vijnë këto cenime dhe mundohet që të ndikojë në ato shtete për të mirën e popullit.

b) Anëtarësimi i të rinjve për punë vullnetare ka filluar shumë herë, kështu që sezoni i sivjetmë do të jetë më i veçantë. Për punë vullnetare “Dora e zgjatur”, ka arritur t’i regjistrojë mbi 400 të rinj të moshave të ndryshme. Në shoqatë mund të regjistrohen edhe 200 të rinj, deri sa të plotësohet numri i përgjithshme prej 600 vetash.

a) _____;

b) _____.

2. Më poshtë janë dhënë dy tekste, andaj duhet të dalloni tekstin informativ nga reklama.

a) Në dyqanin “Don Bosko” që gjendet në rrugën “Dëshmorët e kombit” do të ketë zbritje sezonale dhe atë deri më 13.09.2016. Këpucët janë prodhim vendor dhe Italian, të një kualitet të lartë.

b) Shkolla jonë është e ndërtuar para katërdhjetë vitesh dhe punën ia filloi pas një viti të ndërtimit të saj.

- Në fillim punonin vetëm katër mësues dhe atë në një ndërrim, ndërsa me kalimin e kohës numri i nxënësve u rrit, gjë që edhe personeli arsimor u shtua. Sot shkolla jonë numëron 20 mësues me 420 nxënës.

Në vijëzat e dhëna shkruaj përgjigjen e saktë.

a) _____

b) _____

3. Cilat shprehje nga shtylla A i përgjigjen tekstit përkatës nga shtylla B

A		B	
1	Djathë i kualitetit të lartë		Recetë mjeku
2	Një ditë Nastradini		Letër
3	Aspirine 3x1		Përshkrim
4	E përditshme informative		Reklamë
5	I dashur baba		Recetë ushqimi
6	1 kg mish, 1 qepë, 1 lugë vaj		Gazetë
7	Ishte një lum i bukur gjarpërorë		Anekdote

Vendos numrat para shprehjeve nga kolona A në katrorët përkatës para përgjigjeve të sakta në kolonën B ose të njëjtat lidhi me vizë.

4. Fjalitë e poshtëshënuara janë shkruar gabim, andaj nga ju kërkohet që këto fjali t'i shkruani drejt pa gabime.

1. Tani e kutpojë së shqetsimi i atëhershëm ka qen i tepërtë.

2. Ai ka shum vite pa ardhë në shipri.

5. Me anë të fjalëve të dhëna më poshtë, duke i radhitur fjalët drejt, formo një fjali sipas rregullave gramatikore.

e tharjes, e Luginës, punimet, ditë, së kënetës, u kryen, në fushës, këto.

6. Fjalinë e poshtëshënuar shkruaje drejt në gjuhën standarde me shkronja dore.

Sod erdh ni lajm i mir në shkollën dituria për nxansat dhe msust.

7. Fjalitë e poshtëshënuar lexoji me kujdes, ndërsa për pjesën e hijezuar trego, se në cilën rasë është përdorur.

1. **Shëtitja** të bën mire:
2. **Blinës** fare nuk i këndohej.
3. Qyteti i **Prizrenit** është historik
4. **Rinesën** e zgjodhën nxënësen më të mirë

8. Nga fjalët e dhëna formoni antonime duke i përdorur parashtesat:

anti, ç, sh, zh, s, mos, pa, jo, z, Fjala punë është:

zyrtar- _____

dredh- _____

lodhem- _____

popullor- _____

kurdis- _____

kamje- _____

I ditur- _____

baticë- _____

besim- _____

9. Te fjalët e dhëna vështro rrokjet e fundit.

- | | |
|-------------|----------|
| a) pëdo-rim | b) bo-ra |
| karbo-nik | manda-ti |
| ile-gal | ran-gu |
| bota-nik | zihe-mi |

Trego si quhen këto rrokje:

a) _____

b) _____

10. Jep kuptimin e fjalëve të huaja që janë futur në gjuhën shqipe.

- a) ____ abonim
- b) ____ absorboj
- c) ____ adaptohem
- d) ____ aks

11. Në shembujt e poshtëshënuar nënvizoni pjesën e varur përcaktore dhe rrethoni alternativën përkatëse ku gjendet ajo.

- a) Të nesërmen në mëngjes u nisën vonë, sepse Genti kishte punë në fshat.
 - b) Nuk i dua njerëzit që flasin shumë.
 - c) S'fluturonte zogu, po të mos kishte krahë.
- Rretho përgjigjen e saktë.

12. Në fjalinë e poshtëshënuar duhet të nënvizoni ose të shkruani në vizën e dhënë pjesën e nënrenditur kohore (rrethanën e kohës). P.sh.

Sapo del dielli, befas në pyll zotëron një qetësi e thellë si ajo përpara shtrëngatës.

13. Trego kuptimin e frazeologjizmave të poshtëshënuara.

- 1. I kish varë buzët. _____
- 2. Ishte si daulle e shpuar. _____
- 3. Veshët i ka si bilbili. _____
- 4. Nuk e mban më hundën përpjetë. _____

14. Trego në sa rrokje ndahen fjalët e gjuhës shqipe?

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

- a) *dy rrokje*
- b) *tri rrokje*
- c) *sa zanore ka aq rrokje*

15. Lexo tekstin me vëmendje dhe trego gjininë letrare të cilës i takon?

*Ka nisë provën e provë po ban:
I ka mbledhë nantë gjarpna t'shullanit,
Në gjoks gjarpnat trimi i ka vue,
Sa fort gjarpnat e kanë qokatë,
sa i gjallë kish qenq për t'gjallë s'u ndie!
I ka ndezë dy zjarre të mëdhenj
E ndërmjet Osmanin po na shtjen,
Para e mbrapa lëkura m'i pëlçet,
Gjallë kish' qenë , për t'gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.
M'i ka marrë njëzet maja gozhdash,
për nën thoj thellë ia ka shtie,
derisa gjaku trimit m'i ka dalë
Gjallë kish qenë, për të gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

- a) gjinisë letrare epike
- b) gjinisë letrare lirike
- c) gjinisë letrare dramatike



16. Lexo vargjet e dhëna dhe trego llojin e rimës.

*Gomari hodhi lëkurë dragoi
dhe erdh e t'u bë posi dragua,
dolli me mburrim më një brek qëndroi,
thua se thoshte: Kush më del mua?
Kafshët e tjera posa e pane,
Të gjitha me vrap ikën, e lane.*

Skema e rimës e cila është përdorur në këtë fabul është:

- a) ABABCB
- b) AABBC
- c) ABABCC
- ç) AABABB



- 17.** Këtu poshtë keni të dhënë një pjesë dialogu të marrë nga një vepër letrare. Lexo pjesën e dialogut dhe trego titullin, autorin dhe gjininë letrare të veprës nga është shkëputur kjo pjesë.

Gjergji: Bukur!

Gjini: Këtë për mue!

Gjergji: Shumë mire. Si çunak që je për besë, me shumë fuqi e mjeshtri po gjuen.

Gjini: Edhe po talleh? Nah! Nah!

Gjergji: Të lumtë

Mirushja: Gjini!... U çmende?!

a) Nga cila vepër është nxjerrë ky fragment _____

b) Emri dhe mbiemri i shkrimtarit _____

c) Kjo vepër letrare i takon gjinisë _____

- 18.** Lexo pjesën e tekstit të shkëputur nga drama “AGU”

Zari: Po flisni si burrat. Mua më mban shpresa se ashtu do të bëhet.

Rrapi: Sonte duhet t'ia ndalim turrin dikujt.

Zari: Rrini edhe pak. Ka vend edhe për disa gota.

Pandi: Sulmi kundër tyre duhet të jetë shumë I ashpër.

Rrapi: Për t'ua thyer besimin që kanë në forcat e veta.

Trego cila është mënyra e rrëfimit të ky tekst _____.

19. Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe përcakto figurën stilistike.

Kush të fali bukurinë

Kush ta fali bukurinë
 Që të më tregosh të zinë!
 Kur të pashë për të vluar,
 Pëllumbeshë pendë – shkruar,
 Bubu!plumb në krahëruar
 Plumb që vret duke gjëmuar!

.....
 Leshrave t'ju binte hija
 Yll i ndezur me shkëndia,
 Ndezur mun në mes në ballë,
 të më vesh në dhe të gjallë

Lasgush Poradeci

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) Personifikimi
- b) Metafora
- c) Hiperbola

20. Lexo me kujdes vargjet e poshtëshënuara dhe trego titullin e poezisë, llojin e saj dhe autorin.

Që ditën që vdiqe që kurrë s'të kam parë
 lotët që kam derdhur
 s'më janë dhe tharë

Në ç'kopshte me lule ke qëndruar vallë
 S'të vjen keq për mua!s'të vjen mall për djalë!
 O engjëll I bukur,mos nëno në botë
 Kthehu të të shohë,të na mbeten lotë

- a) titulli i poezisë: _____;
- b) lloji i poezisë: _____;
- c) autori i poezisë: _____.

Rezultati në testin nga gjuha shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!

Rezultati në nivel të detyrës

Rezultati i përgjithshëm në test
(prej 0 deri 20)

		,	
--	--	---	--

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pikët	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

1. _____

2. _____

3. _____

Kontrolluesi:

4. _____

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	